

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë sipas nenit 26 paragrafit (1) Kodit të procedurës Penale të Kosovës (“KPPK”), dhe nenit 15.4 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Rasteve dhe Caktimin e Rasteve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (“Ligji mbi Kompetencat”) të përberë nga:

1. Guy Van Craen, Kryetar i Kolegjit dhe Gjyqtar Raportues
2. Emilio Gatti Gjyqtar i EULEX-it
3. Gerrit-Marc Sprenger Gjyqtar i EULEX-it, Anëtar i Kolegjit
4. Zait Gjemajli, Gjyqtar i Gjykatës Supreme, Anëtar i Kolegjit
5. Avni Dinaj, Gjyqtar i Gjykatës Supreme, Anëtar i Kolegjit

Të asistuar nga Driton Musliu, Asistent ligjor i EULEX-it, Stephen Parkinson, procesmbajtës i gjykatës, Arlinda Gjebrea dhe Lekë Nimani, Përkthyes të EULEX-it;


Në prani të Prokurores publike, Anette Milk EULEX nga Zyra e Prokurorit Publik të Shetit, Avokatëve mbrojtës Tome Gashi dhe Fazli Balaj, dhe të pandehurit Gani Gashi;

Në lëndën penale kundër të pandehurit Gani Gashi, emri i të atit [REDAKTUAR] i lindur më [REDAKTUAR] në Fshatin Komoran, Komuna e Glllogocit, i martuar, Shqiptar i Kosovës, pa dërnime të mëparshme,

i mbajtur në paraburgim prej datës 16 gusht 2007 deri më 16 nëntor 2007, dhe në arrest shtëpiak prej datës 16 nëntor 2007 deri më 2 mars 2009, në paraburgim në pritje të ankësës prej datës 2 mars 2009,

I akuzuar për

- a. vrasje të qëllimshme të I [REDAKTUAR] O [REDAKTUAR] person civil, më 12 korrik 1998, duke e qëlluar atë në shpinë me armë zjarri gjersa I [REDAKTUAR] O [REDAKTUAR] ishte i ulur në veturën Fiat, në rrugën në mes fshatrave Komoran dhe Kishnarekë në Komunën e Glllogocit, Kosovë, dhe si rezultat i kësaj gjuajtje I [REDAKTUAR] O [REDAKTUAR] ka vdekur;
- b. vrasje të qëllimshme në tentativë të Sh [REDAKTUAR] O [REDAKTUAR], person civil, më 12 korrik 1998, duke e qëlluar atë në kokë me armë zjarri gjersa Sh [REDAKTUAR] O [REDAKTUAR] ishte i ulur në veturën Fiat, në rrugën në mes fshatrave Komoran dhe Kishnarekë në Komunën e Glllogocit, Kosovë;



- c. shkelje të integritetit trupor dhe shëndetit të H [REDACTED] O [REDACTED] dhe S [REDACTED] O [REDACTED] persona civilë, më 12 korrik 1998, duke i qëlluar ata me armë zjarri gjersa H [REDACTED] O [REDACTED] dhe S [REDACTED] O [REDACTED] ishin ulur në veturën Fiat, në rrugën në mes fshatrave Komoran dhe Kishnarekë në Komunën e Gllgocit, Kosovë

Me anë të këtyre veprimeve, Gani Gashi ka kryer veprë penale të Krimeve të luftës kundër popullatës civile, në kundërshtim të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ) neni 142, ref. neni 19 sa i përket pikës b, ref Rregullorja e UNMIK-ut 2000/59, në lidhje me rregullat e ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohë të luftës, konfliktit të armatosur, apo okupimit, përkatësisht Konventën e Gjenevës Mbi Mbrojtjen e Civilëve në Kohë të Luftës (tash e tutje Konventa e Gjenevës IV) Nenet 3 dhe 147 dhe në kundërshtim të Protokollit II të Konventave të Gjenevës, Neni 4.

duke vendosur mbi ankesën e paraqitur nga avokatët e tij mbrojtës, Fazli Balaj dhe Tome Gashi, kundër Aktgjykimit P. Nr. 23/2008, të lëshuar nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës më 3 mars 2009,


në seancën, e mbajtur më 8 dhjetor 2009, pas këshillimit dhe votimit, lëshon këtë;

AKTGJYKIM

Aktgjykimi i lëshuar nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës ndryshohet dhe ankesa e avokatit mbrojtës pranohet pjesërisht, në veçanti sa i përket dënimit të shqiptuar.

Vendimi i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës vërtetohet, përveç:

1. Referimi ndaj nenit 147 të Konventës së Katërt të Gjenevës, relative me Mbrojtjen e Personave Civilë në kohë të Luftës, 12 gusht 1949, është **Eliminuar**;
2. Elementet e veprës penale duhet të saktësohen se ajo veprë është kryer gjatë konfliktit të armatosur, se i pandehuri ishte ushtar i UÇK-së në një pikë-kontrolli i armatosur me AK 47 (Kallashnikov).
3. Dënimi ndryshohet duke shqiptuar një dënim me 15 (pesëmbëdhjetë) vjet burgim duke zvogëluar dënimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.
4. Aktgjykimi po ashtu ndryshohet sa i përket llogaritjes së kohës së kaluar në paraburgim, prandaj, koha e kaluar në paraburgim nga data 16 gusht 2007 deri më 16 nëntor 2007, dhe arresti shtëpiak që nga data 16 nëntor 2007 deri më 2 mars 2009, do të llogariten si pjesë e dënimit.



Arsyvetimi Gani Gashi.

1) Historia e procedurës

Gjykata e shkallës së parë, Gjykata e Qarkut të Prishtinës, dënoi të pandehurin Gani Gashi më 3 mars 2009.

Ankesat e të pandehurit të paraqitura me kohë përmes avokatëve të tij Fazli Balaj dhe Tome Gashi, përkatësisht më 28 prill 2009 dhe 7 maj 2009, janë të lejueshme.

Gjykata Supreme, si instancë e apelit, vendosi të mbajë një seancë më 8 dhjetor 2009 dhe dëgjoi të gjitha palët e përfshira, duke përfshirë edhe palën e dëmtuar.


Pas këshillimit, kolegji më 8 dhjetor 2009 bëri shpalljen publike të aktgjykimit të Gjykatës Supreme, duke e lexuar dispozitivin. Një aktvendim i veçantë është lëshuar në ditën e njëjtë mbi paraburgimin e të pandehurit.

2) Vlerësimi i gjykatës mbi ankesat.

Ankesat e të pandehurit ngritën disa çështje interesimi sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga Gjykata e shkallës së parë, përkitazi me shkeljen esenciale të KPPK-së dhe KPK-së dhe përkitazi me dënimin.

2.1. Vërtetimi i gjendjes faktike :

Gjykata Supreme në analizën e vet ndaj aktgjykimit të kundërshtuar konstaton se gjykata e shkallës së parë vërtetoi gjendjen faktike saktë dhe preciz në pajtueshmëri me metodat ligjore të gjetjes së fakteve duke u bazuar në vlerësimin e dëshmimeve të paraqitura para Gjykatës siç është përshkruar në arsyetimin e Gjykatës. Kundërt me ankesat Gjykata e shkallës së parë vërtetoi të gjitha rrethanat e veprave penale në mes tjerash: personat e pranishëm, viktimat dhe plagët e tyre, lëvizjet dhe veprimin e të pandehurit dhe armën e përdorur, trajektoren e predhës (plumbit), kohën përfaqë, errësirën në kohën e krimit, rrugën, pikën e kontrollit dhe praninë e ushtarëve të UÇK-së në detyrën e tyre ushtarake. Gjykata e shkallës së parë qartazi theksoi se “nuk ka dëshmi – që është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar – se ishte më shumë se një e shtënë zjarri“. Me këto dëshmi të paraqitura, Gjykata e shkallës së parë rindërtoi saktësisht lëvizjet dhe veprimet e të gjithë personave të përfshirë në këtë dramë pra: përpara, gjatë dhe pasi është shkrepur zjarri dhe pasojat e sakta të gjuajtjes. Fakti se S [REDACTED] në një ngjarje tjetër më vonë ishte plagosur (nga një granatë dore) nuk përbën, përveç nëse provohet, një dëshmi *a contrario*.



Pa asnjë dyshim është vërtetuar se S [REDACTED] O [REDACTED] është plagosur me plumbin e shtënë nga i pandehuri në veturë.

Gjykata e shkallës së parë la përcaktuar në mënyrë të duhur dhe me saktësi të plotë gjendjen faktike. Përcaktimi dhe përshkrimi në motivimin e gjykatës së parë është konfirmuar nga Gjykata Supreme dhe konsiderohet si e vetja.

2.2 Shkelja esenciale e KPPK-së dhe shkelja e KPK-së.

Gjykata Supreme vëren se në të vërtetë dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë përmban disa mangësi:

- referimi në nenit 147 të Konventës së Gjenevës IV
- mungesa e saktësimi të elementeve në kualifikimin e krimeve të luftës
- mungesa e citimit ligjor me të cilin përshkruhet se dënimi duhet të zvogëlohet me kohën e kaluar në paraburgim dhe/ose arrest shtëpiak.
- dënimi nuk është përcaktuar në mënyrë korrekte.

Këto mangësi edhe pse në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm NUK përbëjnë shkelje esenciale të KPPK-së dhe nuk e bëjnë të domosdoshme që Gjykata Supreme ta anuloj aktgjykimin e ankimuar (neni 424 (1) KPPK-së).

Gjykata Supreme vendos në pajtim me nenin 426 (1) të KPPK-së duke pas parasysh se gjendja faktike (shih më lart) është përcaktuar në mënyrë të duhur.

a) Dispozitivi duhet të lexohet së bashku (si tërësi) me arsyetimin dhe vërtetimin e qartë të gjendjes faktike të bërë nga (gjykata e shkallës së parë).

Të gjeturat dhe motivimi i gjykatës së shkallës së parë tregon qartë:

- elementet e krimeve të luftës sepse i pandehuri ka vepruar gjatë konfliktit të armatosur të brendshëm (jo konflikt i armatosur ndërkombëtar siç përshkruhet në 147 Konventën e Gjenevës)) si ushtarë i UÇK-së, i armatosur me armë luftarake (AK 47), në detyrë si ushtarë i UÇK-së në një pikë kontrolli të instaluar nga UÇK-ja, kundër civilëve (viktimave); Gjykata i është referuar situatës në atë kohë në Kosovë, dhe edhe pse nuk ka pasur luftime në atë moment në atë vend, është konstatuar në mënyrë korrekte sipas jurisprudencës ndërkombëtare dhe vendore se në atë kohë ka pasur konflikt të armatosur në Kosovë dhe në veçanti në atë zonë (vendin e krimit) gjithashtu. Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar, pa lënë asnjë dyshim se vepra penale e të pandehurit duhet të kualifikohet si krim lufte. Për më tepër, nënkuptohet se gjendja faktike siç është përshkruar nga gjykata e shkallës së parë *inter alia*: veprimet e ushtarëve të UÇK-së të armatosur me armë gjysmë-automatike, pikat e kontrollit dhe gërmimi dhe organizimi i vendstrehimeve të sigurta dhe kontrollimi i tërë trafikut në vendin e krimit, janë së paku dëshmi mbështetëse të konfliktit të armatosur. Gjykata Supreme i përmbahet arsyetimit të gjykatës së shkallës së parë.

- Në përgjigjen në ankesë, Gjykata Supreme ka nënvizuar se krimi i luftës i kualifikuar nuk kërkon që vepra ilegale të kryhet kundër një grumbulli njerëzish (që përkrahin armikun) dhe nuk kërkon betejë (efektive) dhe/ose luftim në mes të forcave të armatosura në vendin e krimit. Në këtë rast është dëshmuar se konflikti



i armatosur ka qenë duke u zhvilluar në atë zonë dhe rrethinë ku i pandehuri qëllimshëm ka vrarë [REDAKTUAR] O [REDAKTUAR] vrasje të qëllimshme në tentativë ndaj S [REDAKTUAR] O [REDAKTUAR] dhe qëllimisht ka shkelur integritetin trupor dhe shëndetin e H [REDAKTUAR] O [REDAKTUAR] dhe S [REDAKTUAR] O [REDAKTUAR]

- Për hir të qartësisë: sipas Konventës së Gjenevës IV të përmendur:


1. dispozita e lidhur me civilët e MBROJTUR (si në këtë lëndë) gjen aplikim në tërë territorin e palëve në luftë pavarësisht nëse luftimet ndodhin në secilin regjion apo jo;
2. kushtet për të qenë i aplikueshëm më tutje “organizimi, komanda e përgjegjëse, kontrollim mbi një pjese të territorit, operacionet ushtarake të gjata dhe aftësia e implementimit të Ligjit Ndërkombëtar Humanitar” (Protokolli shtesë II)

Siç është cekur më lart ato elemente substanciale janë plotësuar në këtë lëndë.

- Prandaj Gjykata Supreme në dispozitiv ka bërë saktësimin në kualifikimin e të gjitha elementeve përbërëse të krimeve të luftës dhe fshin referimet e bëra për konfliktin ndërkombëtar të armatosur (neni 147 i Konventës së Gjenevës IV) në kualifikimin e krimeve të luftës.

b) Gjykata Supreme nuk pajtohet me konstatimin në ankesa me të cilën thuhet se i pandehuri nuk ka pasur qëllim për të vrarë, asnjë motiv dhe/ose që ai ka vepruar në neglizhencë. Gjykata Supreme duke i vlerësuar dëshmitë në mënyrë ligjore të prezantuara në gjykatën e shkallës së parë, vëren se qëllimi për të vrarë është dëshmuar me faktin se i pandehuri pa paralajmërim ka shtënë nga arma e tij AK47 (armë luftarake) në veturë, me dijeni të plotë se vetura ishte plot me njerëz (përfshirë një fëmijë 6 vjeçar i cili ishte i ulur në prehrin e të ndjerit) dhe duke vepruar në këtë mënyrë ai e ka ditur fare mirë, pasi i kishte parë personat e ulur në veturë një minutë më parë, ai do ta vriste dhe plagoste vozitësin dhe/ose pasagjerët. Mbrojtja, duke thënë se ishte një aksident, se i pandehuri ka dashur të shtie në ajër, nuk qëndron për shkak të fakteve të lartpërmendura, kushtet e rrugës dhe indikacionet gjeografike. Trajektorja e plumbit (nga lart poshtë) tregon qartë se i pandehuri e ka marrë në nishan xhamin e pasmë të veturës, duke e ditur me siguri se plumbi do të depërtoj në zonën e pasagjerëve brenda veturës. Motivi i këtij krimi është (në të vërtetë) i panjohur., mirëpo si i tillë kjo rrethanë nuk ka rëndësi (në këtë lëndë) në përcaktimin e qëllimit (elementeve të moralit) të krimit.

c) Ligji penal i aplikueshëm me të cilin duhet t përcaktohet dënimi, është ligji më i favorshëm për të pandehurin. Duke e marrë parasysh datën e fakteve penale, ligji më i favorshëm është KP RSFJ-së neni 142 (1) i vitit 1977/1993 duke e pas parasysh Rregulloren e UNMIK-ut 2000/59 (shfuqizimi i dënimit me vdekje). Gjykata e shkallës së parë ka dënuar të pandehurin me dënim (jologjor) prej 17 vjet në vend të dënimit prej 20 vjet burgim ose dënimit deri në 15 vjet burgim. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur për 17 vjet burgim e cila nuk është ligjërishit e përshkruar.



Në këtë rast, duke e pasur parasysh se ankesa nuk mund ta dëmtojë ankuesin (të pandehurin), dënimi maksimal për krimin (krim lufte- vrasje e qëllimshme) është vjet burgim. Gjykata Supreme pajtohet me mendimin e Prokurorit publik.

Prandaj, Gjykata Supreme vendosi që të dënoj të pandehurin me dënim prej 15 vjet burgim për arsye se:

- vetë krimi dëshmon manifestimin e sjelljes së rrezikshme kriminale të të pandehurit
- viktimat (palët e dëmtuara) janë ende duke vuajtur nga dëmtimi i pamasë i moralit
- i pandehuri nuk tregon ndjeshmëri ndaj këtyre viktimave.
- pasojat serioze sociale për shoqërinë të shkaktuara nga veprat e tij.

Prandaj ky burgim i përcaktuar është i nevojshëm për të sjellë një pasqyrë të domosdoshme, perceptim dhe mirëkuptim lidhur me sjelljen e tij kriminale më mënyrë që ai të jetë në gjendje të funksionoi si qytetar i ndershëm dhe i qetë dhe i parrezikshëm për njerëzit që e rrethojnë. Një dënim më i vogël, duke e pas parasysh personalitetin e rrezikshëm të të pandehurit, veprat e mëdha penale që ai i ka kryer kundër civilëve plotësisht të pafajshëm (përfshirë një fëmijë) nuk mund të merren parasysh edhe pse Gjykata Supreme është e njoftuar me faktin se i pandehuri është i martuar dhe është baba, se nuk ka dosje të mëparshme penale dhe se faktet penale janë kryer më 12 qershor 1998.

d) Gjykata Supreme nënvizon se koha e kaluar në paraburgim dhe arresti shtëpiak duhet të zbriten nga kohëzgjatje e burgimit të lartpërmendur.

Për arsyet e cekura më lart, Gjykata Supreme, si kolegji i ankesave, ka vendosur në pajtim me nenin 426 (1) të KPPK-së – se aktgjykimi i shkallës së parë duhet të vërtetohet përveç ndryshimeve të përcaktuara në diapozitiv. Vendimi mbi paraburgimin e mëtutjeshëm të të dënuarit është lëshuar me një aktvendim të ndarë dhe specifik.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

AP- K Nr. 191/2009

8 dhjetor 2009

Kryetar i kolegjit

Guy Van Craen

Anëtar i kolegjit

Emilio Gatti

Anëtar i kolegjit

Gerrit Marc Sprenger

Anëtar i kolegjit

Zai Gjemajli

Anëtar i kolegjit

Adrian Dinaj

